

# Sabri Kastrati




PROKUROR NË PROKURORINË PRANË  
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM,  
LEZHË

Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2006 deri  
Periodik/Vjetor 2019)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2019



Pasuria bruto nga fillimi i detyrës deri me  
datë 31.12.2019 është rritur 140.62 herë

+ 2,444,152 Lekë rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete  
në Cash

1,901,410

Para Fillimit të Detyrës      Datë 31/12/2019

Pasuritë e  
Luajtshme

745,080

245,080

Para Fillimit të Detyrës      Datë 31/12/2019

31,816,720

Para Fillimit të Detyrës      Datë 31/12/2019

Pasuritë e  
Paluajtshme

## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2006-2019	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga nga funksioni	18,000,092	40.9%
Paga e familjarëve	18,305,869	41.6%
Të ardhura nga Qira	5,944,800	13.5%
Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme	396,286	0.9%
Te ardhura te tjera	1,333,580	3.0%
<b>Total</b>	<b>43,980,627</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

1 Me probleme  
13 Pa Probleme



Kontrolli aritmetik/ logjik për vitin 2013 rezultoi me probleme, pasi subjekti Sabri Kastrati deklaroi blerjen e një apartamenti me vlerë 100,000 euro, për të cilin nuk ka të dhëna mbi pagesat e kryera dhe burimin financiar.

Në deklaramin Para Fillimit të Detyrës 2005, subjekti deklaroi se në bashkëpronësi me vëllezërit zotëron një objekt 5 katësh: supermarket, restorant, hotel, garazh në qytetin e Kukësit, e krijuar në vitin 1998. Lidhur me këtë objekt, mungojnë të dhënat mbi shumën e investuar nga subjekti dhe familjarët e tij, si dhe nuk ka informacion nëse ky objekt gjeneron apo jo të ardhura.

Në deklaramin Periodik/Vjetor 2016 dorëzuar me datë 28.03.2017, bashkëshortja e subjektit deklaroi se në janar 2017 ka marrë dijeni për ekzistencën e një kontrate poroshie datë 08.08.2014, sipas së cilës rezultoi se ka porositur një apartament banimi 68.2 m<sup>2</sup> në vlerën 61,000 euro, por faktikisht ajo nuk ka qenë prezent dhe kontrata është lidhur nga prindërit e saj, të cilët për rrethana familjare e kanë vendosur në emrin e saj. Këtë fakt ajo e mbështet me deklaramin noteriale datë 29.01.2017, e përpiluar nga prindërit e saj.